

**RELACION**  
**PËR**  
**PROJEKTUDHËZIMIN**  
**PËR**  
**“RADHËN E VENDOSJES SË ELEMENTEVE TË ADRESËS,**  
**ALGORITMIN DHE STRUKTURËN E KODIT UNIK TË ADRESËS**  
**DHE PËRDORIMIN E TIJ”**

Projektudhëzimi “Për radhën e vendosjes së elementeve të adresës, algoritmin dhe strukturën e kodit unik të adresës dhe përdorimin e tij”, është propozuar në vijim të miratimit të ligjit nr. 53/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9270, datë 29.7.2004, “Për sistemin e adresave”, të ndryshuar”, sipas parashikimeve në pikën 3, të nenit 3.

Miratimi i këtij projektudhëzimi synon përmirësimin e sistemit të adresave dhe optimizim në tërësi të shërbimeve publike, përfitues të të cilëve janë pa përjashtim të gjithë shtetasit.

Në vijimësi të procesit të adresimit të pjesëve të territorit publik, informacioni për adresat e ndërtesave standardizohet nëpërmjet kodit unik të adresës, i cili përbën një ndër elementët e saj, në mënyrë që të sigurohet një strukturë korrekte e adresës, që përmban informacion specifik të të dhënave të vendbanimit të shtetasve.

Përcaktimi i standardit sipas strukturës së propozuar i vjen në ndihmë shtetasve të memorizojnë të dhënat e adresës sipas 8 (tetë) elementëve të parë që i korrespondojnë elementëve të ndërtesës.

Projektudhëzimi i propozuar për miratim është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, nenit 100, pika 4 dhe është hartuar në zbatim të nenit 3, pika 3, të ligjit nr. 9270, datë 29.07.2004 ligjit nr. 53/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9270, datë 29.7.2004, “Për sistemin e adresave”, të ndryshuar”.

Përcaktimi i kodit unik të standardizuar ka qenë në fokus të çështjeve prioritare në kuadër të nismës së ndërmarrë në Komitetin e Inovacionit, më datë 15.07.2022, ku krijimi i një kodi unik si përfaqësues unik i adresës, u parashikua

të jetë deri në nivel ndërtese.

Bazuar në urdhrin nr. 208, datë 27.12.2022 të Kryeministrit "Për krijimin e grupit ndërinstucional të punës për përmirësimin e sistemit kombëtar të adresave dhe ndërlidhjen e Regjistrit Kombëtar të Adresave me bazat e të dhënave shtetërore" ku parashikohet se: "Bashkërendimi i punës për përcaktimin e metodologjisë për mënyrën e kodimit (algoritmit) dhe strukturës së kodit unik të adresës", veprimtaria për këtë nisëm u fokusua si një ndër përgjegjësitë kryesore dhe detyrat e grupit të punës.

Për sa më sipër, ky projektakt duhet t'i dërgohet për mendim dhe anëtarëve të grupit të punës të ngritur me urdhrin nr. 208, datë 27.12.2022 të Kryeministrit, respektivisht si vijon:

- Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës;
- Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore;
- Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI);
- Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor;
- Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (AShK);
- Agjencisë së Zhvillimit të Territorit (AZhT);
- Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve;
- Postës Shqiptare sh.a.;
- Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve;
- Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB);
- Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a.; dhe
- Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMMV);

Metodologjia e aplikuar për standardizimin e kodit unik të adresës i referohet modelit të propozuar prej 18 (tetëmbëdhjetë) karakteresh në total sipas modelit logjik, ku 2 (dy) karakteret e para i përcaktojnë bashkinë dhe karakteret e tretë dhe të katërt përcaktojnë kodin postar. Karakteret në pozicionet e 5-të, të 6-të, të 7-të dhe të 8-të, i korrespondojnë një kombinimi të 2 (dy) gërmave dhe 2 (dy) numrave, të krijuar në mënyrë të rastësishme për çdo ndërtesë nëpërmjet Regjistrit Kombëtar të Adresave (RKA). Karakteret e 9-të, të 10-të, të 11-të, të 12-të dhe të 13-të, i korrespondojnë numrit ekzistues të hyrjes. Karakteri i 14-të tregon pozicionimin e apartamentit nën tokë / mbi tokë.

Karakteret e 15-të, 16-të, 17-të dhe 18-të i korrespondojnë numrit ekzistues të apartamentit.

E dhëna për kodin unik të adresës, është e papërsëritshme. Tetë elementët e parë të kodit unik të adresës, që i referohen kodit unik të ndërtesës ndihmojnë në memorizimin lehtësisht të tij nga shtetasit.

Kjo e dhënë përcaktohet vetëm për shtetasit shqiptarë me vendbanim në territorin e Republikës së Shqipërisë. Për shtetasit shqiptarë me vendbanim jashtë vendit, adresa plotësohet sipas elementëve të adresës së shtetit të huaj.

Për hartimin e këtij projektudhëzimi është bashkëpunuar dhe përfaqësuesin e Postës Shqiptare sh.a.

Ky projektudhëzim përbëhet nga 3 (tre) krerë, me përmbajtje si më poshtë:

Në pikën një të projekt-udhëzimit, parashikohet mënyra e standardizimit të shkrimit të elementëve të adresës. Emërtimet e pjesëve të territorit publik, rrugë/bashki/njësi administrative kryhen me germa të mëdha. Elementët për numërtimin e ndërtesës, hyrjes dhe apartamentit shkruhen në një rresht dhe ndahen ndërmjet tyre me shenjën e pikësimit “ ; ”.

Në pikën dy të projekt udhëzimit parashikohet se elementët për numërtimin e ndërtesës, hyrjes dhe apartamentit shkruhen në një rresht dhe ndahen ndërmjet tyre me shenjën e pikësimit “ ; ”.

Në pikën tre të projekt udhëzimit parashikohet se emërtimet sipas elementëve fshat/qytet/njësi administrative dhe kod postar, shkruhen në një rresht, të ndarë midis tyre me shenjën e pikësimit “ ; ”.

Në pikën katër të projekt udhëzimit parashikohet se kodi unik i adresës, si ndarje më vete shkruhet në rreshtin e fundit. Kjo e dhënë alfanumerike sigurohet në bazë të konsultimit dhe kërkimit në faqen e adresarit, e cila funksionon e hapur për publikun, sipas linkut <https://rka.mb.gov.al> / <https://adresari.mb.gov.al>.

Në kreun II të projektudhëzimit parashikohet mënyra dhe modeli i shkrimit të adresës, sipas rasteve të specifikuara në germat a., b., c., ç., d. dhe dh., ku konkretizohen raste:

- a. për adresën e ndërtesave të ndodhura nën juridiksionin e Bashkisë Tiranë;
- b. për adresën e ndërtesave kur emërtimi i qytetit përkon me emërtimin e njësisë administrative, njësia administrative nuk vendoset;
- c. për adresën kur emërtimi i qytetit dhe njësisë administrative është i njëjtë, por emërtimi i bashkisë është i ndryshëm;

- ç. për adresën kur emërtimi i njësisë administrative është i ndryshëm nga ai i bashkisë;
- d. për adresën kur emërtimi i një fshati është i ndryshëm nga emërtimi i bashkisë dhe i njësisë administrative; dhe
- dh. për adresën kur emërtimi i fshatrave përkon me emërtimin e njësisë administrative;

Në pikën e parë, të kreut të dytë të projekt-udhëzimit parashikohet se ushtrimin e veprimtarisë së tyre të gjitha institucionet publike dhe jopublike, personat juridikë dhe fizikë respektojnë modelin e adresës sipas formateve të miratuara.

Në pikën e dytë, të kreut të dytë të projekt-udhëzimit parashikohet se algoritmi dhe struktura standarde e kodit unik të adresës si element i adresës, shërben për të identifikuar në mënyrë unike vendndodhjen e çdo ndërtese, si dhe të hyrjeve, apartamenteve në brendësi të saj. Kodi unik i adresës si një nga elementet e adresës është një vlerë alfanumerike, gjithsej 19 (nëntëmbëdhjetë) karaktere.

8 (tetë) karakteret e para të kodit unik të adresës, si ndarje më vete përbëjnë kodin unik të ndërtesës. Përditësimi dhe saktësimi i këtij kodi ndodh në varësi të ndryshimeve që mund të pësojnë elementët që e përbëjnë atë, respektivisht kufijtë territorialë të bashkisë dhe kodi postar. Tetë karakteret e para identifikohen si nënkodi i ndërtesës, të strukturuar me informacion të koduar si një e dhënë e papërsëritshme.

Në pikën e dytë të kreut të tretë të projekt-udhëzimit, parashikohet se kodi unik i adresës strukturohet si më poshtë:

- karakteret në pozicionin 1 dhe 2, i korrespondojnë kodit 2 (dy) shifror të bashkisë, të modeluar sipas aneksit nr. 1 dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi;

Përcaktimi i këtyre 2 (dy) karaktereve është ideuar sipas strukturës ligjore, të miratuara me ligjin nr. 115/2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisë të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë".

- karakteret në pozicionin 3 dhe 4, i korrespondojnë 2 (dy) shifrave të fundit të kodit postar në bashkinë që i korrespondin sipas të dhënave në aneksin nr. 1, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi;

Karakteri i 3-4, i korrespondon 2 (dy) shifrave të fundit të sistemit të kodit postar, në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon këtë veprimtari. Sistemi i Kodit Postar është miratuar me vendimin nr. 676, datë 4.10.2006 të Këshillit të Ministrave "Për kodin postar në Republikën e Shqipërisë", i cili duhet të

aplikohet gjerësisht në shërbimin publik postar dhe të jetë i unifikuar për të gjithë ofruesit e shërbimit postar.

Përfshirja e këtij elementi bëhet në vijim të Dokumentit të Politikës së Shërbimeve Postare në Republikën e Shqipërisë, për periudhën e viteve 2021-2026, miratuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikës, ku sistemi i adresave përcaktohet si një ndër problematikat e shërbimit postar dhe që i shërben saktësimi të sistemit të adresave. Kodi Postar pasqyrohet dhe në të dhënat e shtetasve në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC) të vitit 2010.

- karakteret në pozicionet 5, 6, 7 dhe 8, i korrespondojnë një kombinimi të 2 (dy) germave dhe 2 (dy) numrave, të krijuar në mënyrë të rastësishme për çdo ndërtesë nëpërmjet Regjistrin Kombëtar të Adresave (RKA). Karakteret në pozicionet 5 dhe 6 përbëhen nga germa kapitale të alfabetit latin (përveç germës "W"), sipas rastit nga "AA", në "ZZ". Karakteret në pozicionet 7 dhe 8 përbëhen nga numra natyrorë, nga "01" deri në "99";

- karakteret në pozicionet 9, 10, 11, 12 dhe 13, i korrespondojnë numrit të hyrjes në ndërtesë. Për numërtimin e hyrjes së ndërtesës në këto karaktere aplikohet metodologjia e mëposhtme:

- a. hyrjet e numërtuara me shifër, marrin vlerat nga 00001, në 00099;
- b. hyrjet e numërtuara me shifër dhe fraksion, marrin vlerat nga 01/01 në 99/99;

Pjesa tjetër e kodit unik të adresës, sipas 10 (dhjetë) elementëve të fundit që i korrespondojnë nënkodit të pjesës së brendshme të ndërtesës është propozuar të jetë e strukturuar prej karaktereve të 9-10-11-12-13.

Karakteret e 9-10-11-12-13-të, i korrespondojnë numrit ekzistues të hyrjes dhe përputhen me numrin e hyrjes në ndërtesë. Karakteri i 9-10-11-të përputhet me numrin e hyrjes. Karakteri i 12-13-të përputhet me numrin e fraksionit të hyrjes, nëse ka. Përllogaritja e dy numrave të fundit bëhet nga "00 100", në "99 999".

- karakteret në pozicionet 14, 15, 16, 17, 18 dhe 19, i korrespondojnë numrit të apartamentit në ndërtesë. Për numërtimin e apartamentit të ndërtesës në këto karaktere aplikohet metodologjia e mëposhtme:

- a. apartamentet e numërtuara me shifër, marrin vlerat nga 000001, në 000999;
- b. apartamentet e numërtuara me shifër dhe fraksion, marrin vlerat nga 001/01, në 999/99;
- c. në rast të bashkimit të dy ose më shumë apartamenteve, apartamenti i krijuar nga ky bashkim do të ketë kodin unik me numrin më të vogël. Në rast të ndarjes së një apartamenti aplikohen të njëjtat rregulla si më lart të përshkruar;

Karakteri i katërbëdhjetë i korrespondon vendndodhjes së apartamentit/dyqanit/biznesit/etj. Për objektet nën tokë vendoset shenja “-”. Për objektet mbi tokë vendoset shenja “+”.

Karakteret e 15-16-17-18, i korrespondojnë numrit ekzistues të apartamentit dhe përputhen me të tre numrat e parë, me numrin e apartamentit/dyqanit/biznesit/etj. Numri i fundit përputhet me numrin e fraksionit të apartamentit/dyqanit/biznesit/etj., nëse ka dhe përlogaritë nga “0010”, në “9999”.

Në pikën e tretë të kreut të tretëprojekt-udhëzimit, parashikohet se kodi unik i adresës, evidentohet në të dhënat e shtetasve për vendbanimin, si rubrikë më vete në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC) të vitit 2010.

Në pikën katërt të kreut të tretë të projekt-udhëzimit, parashikohet se kodi unik i adresës krijohet për ndërtesat e regjistruara në Regjistrin Kombëtar të Adresave (RKA), sipas aneksit nr. 2, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

Në pikën pestë të projekt-udhëzimit, parashikohet ngarkimi i Drejtorisë së Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe bashkitë si organ i parë i qeverisjes vendore për zbatimin e këtij udhëzimi.

MINISTRI  
Ervin Hojha

